

AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"Shpresa-Al.trans " shpk

Ne Tirane, sot me date 24/08/2020, me cilesine e "ortakut themelues " une : Z.Arjan Saliasi, i datëlindjes 13/01/1967, identifikuar me leternjoftim me nr.personal G70113035E, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, me vullnet të lire, të plote e të sinqerte, mbeshtetur ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare " i ndryshuar, ne ligjin 9723, datë 03.05.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, kam vendosur të krijoj shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "Shpresa-Al.trans " shpk, (me poshte e quajtur "Shoqeria")

KREU I

Neni 1

Krijimi

Shoqeria "Shpresa-Al.trans" shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria "Shpresa-Al.trans" shpk, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga "ortaku i vetem", i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë. Ortaku gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline kryesore, ne adresen :Rruga 'Hajdar Tafa', nr. Pasuire 65/101 zona kadastrale 3292, Selite e vogel, Tiranë.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Shoqëria ka për qëllim: Të kryejë transport kombëtar dhe ndërkombëtar të mallrave.

Neni 5

Kohezgjatja



Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

KREU II KAPITALI

Neni 6 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 leke, i ndarë në një kuotë.

Z.Arjan Saliasi eshte zoterues i 1 kuote me vlere 100 000 leke, e cila perfaqeson 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajshme/të paluajshme apo të drejta)
Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 7 Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote të legjislacionit shqiptare.
Per sa nuk parashikohet ne kete Akt Themelimi, do te parashikohen në Statut dhe do të zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 8 Dispozita perfundimtare

Ky Akt themelimi i shoqerise "Shpresa-Al.trans " shpk, u redaktua nga une "ortaku themelues" ne 4 ekzemplare me vlere te njejta juridike ne gjuhen shqipe me permbajtje dhe vlere te njejta juridike.

ORTAKU I VETEM
"Shpresa-Al.trans " shpk

Z. Arjan Saliasi